



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E FINANÇAVE - MINISTARSTVO ZA FINANSIJE - MINISTRIUM FÜR FINANZEN
Njësia për Inteligjencë Financiare - Financijeski Obaveštajna Jedinica - Financial Intelligence Unit
Nr./Sh. FIUAD: 52/2021 Nr./Sh./Archi: - 16 -
Data/Vitet: 18/02/2021
PËRSHTIMË - ПРШТИМА - PROTIŠTA

NJËSIA PËR INTELIGJENCË FINANCIARE
FINANSIJSKA OBAVEŠTAJNA JEDINICA
FINANCIAL INTELLIGENCE UNIT

Datë: 18/02/2021
FIUAD: 52/2021

Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës,

bazuar në paragrafin (1.11) të nenit 14 të Ligjit Nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 18, 15 Qershor 2016) nxjerr këtë:

**UDHËZUES PËR SUBJEKTET RAPORTUESE
PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË
TERRORIZMIT SI DHE RREZIQET E PP/ FT QË NDËRLIDHEN ME COVID-19**

Ky udhëzues paraqet një përmbledhje të shkurtër të rreziqeve të PP/FT që ndërlidhen me situatën e krijuar nga pandemia COVID-19, ndikimit që ato kanë në aktivitetin parandalues dhe masat që duhet të ndërmerren nga subjektet raportuese, për zvogëlimin dhe zbutjen efektive të tyre. Udhëzuesi përmban edhe shtojcën (1) e cila përmban listën e indikatorëve/treguesve të cilët mund të ndihmojnë subjektet raportuese për të identifikuar, raportuar dhe parandaluar rreziqet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të shkaktuara gjatë periudhës COVID-19, si dhe tipologji të trendëve dhe rasteve të fundit (shtojca 2) që ndërlidhen me situatën e krijuar nga pandemia COVID-19.

Ndryshimet në trendët e rrezikut të PP/FT gjatë pandemisë COVID-19 janë shoqëruar me mënyra të ndryshme të reagimit nga qeveritë, të cilat përfshijnë ndihma sociale, nismat e lehtësimit të obligimeve tatimore, masat e kufizimit të lëvizjes dhe udhëtimeve. Ndërmarrja e këtyre masave mund të ofrojë mundësi të reja për kriminelët dhe terroristët, për të siguruar të ardhura të jashtëligjshme dhe mundësuar procesin e pastrimit të tyre.

Bazuar në analizimin e informacionit, burimeve të hapura dhe reagimet e marra nga subjektet raportuese në nivel ndërkombëtar në vijim paraqiten disa nga çështjet që kanë të bëjnë me veprat e ndërlidhura penale dhe rreziqet e PP/FT.

Rreziqet e reja gjatë periudhës COVID-19¹

Faktorët kryesorë që janë duke nxitur këto rreziqe të reja gjatë periudhës COVID-19 janë si në vijim:

¹ECOFEL, 2020 - Covid-19 Best Practices for Financial Intelligence Units

- Ndryshime në kërkesën dhe ofertën e mallrave dhe shërbimeve, veçanërisht në lidhje me mallra të tilla si pajisje mbrojtëse personale, testet COVID-19 dhe produktet farmaceutike;
- Ulja e lëvizshmërisë dhe fluksit të njerëzve: për shkak të pandemisë në vazhdim, rritja e kufizimeve të udhëtimit ka ndikuar në uljen e lëvizjes dhe fluksit të njerëzve. Shumë krime transnacionale, të tilla si trafikimi i drogës, njerëzve, kontrabandës, armëve të zjarrit dhe jetës së egër pritet të preken nga këto kufizime të udhëtimit;
- Ndryshimet në praninë në internet të njerëzve: situata aktuale globale ka ndikuar shumë në jetën e përditshme të gjithsecilit, sipas Institutit të Stabilitetit Financiar, rreth 300 milion punonjës zyre mund të kenë punuar nga shtëpia në Maj 2020, duke përfshirë 90% të punonjësve të bankave dhe sigurimeve. Me një mbështetje të shtuar në mjetet e komunikimit në internet për të qëndruar të lidhur me punën dhe kolegët, njerëzit janë në internet më shumë se kurrë më parë;
- Rritja e ankthit dhe frikës: për shkak të pandemisë, qytetarët po përjetojnë më shumë ankth dhe frikë dhe gjithçka është nën kërcënim. Reagimi njerëzor është një grumbullim ankthi dhe frike që krijon çënueshmëri ndaj shfrytëzimit të tyre nga keqbërësit;
- Ulja e furnizimit me mallra të paligjshme: Zhvendosja në furnizimin e mallrave të paligjshëm bën që sasia e konsumuar të ulet ndërsa çmimi rritet;
- Prokurimi emergjent: Prokurimi emergjent mund të rrisë rreziqet e korrupsionit. Më tej, mungesa e furnizimit do të rrisë rrezikun e korrupsionit në prokurimin e këtyre mallrave;
- Masat stimuluese dhe ndihma ndërkombëtare dhe e brendshme: Kriminelët mund të bëjnë pretendime mashtruese mbi fondet stimuluese të qeverisë duke u paraqitur si biznese të ligjshme që kërkojnë ndihmë.

Rritja e mashtrimeve: Të dhënat e raportuara në nivelin ndërkombëtar tregojnë se gjatë kësaj periudhe kriminelët kanë provuar të shfrytëzojnë gjendjen e pandemisë për të mbledhur fonde për organizata bamirëse fiktive, mashtrime në fushën e mjekësisë (përfshirë këtu dhe mashtrimet për investime) dhe shitjet në internet të barnave të falsifikuara dhe furnizimeve mjekësore, siç janë pajisjet e testimit dhe ato që shërbejnë për mbrojtjen personale.

Në vijim paraqiten disa nga mënyrat e përdorura për këtë qëllim:

- duke u prezantuar si zyrtarë të qeverisë;
- falsifikimi, përfshirë këtu produkte thelbësore (furnizimet mjekësore dhe barërat)

- mbledhja e fondeve për organizata fiktive në fushën e bamirësisë;
- skema të mashtrimit në fushën e investimeve;

Krimi në internet: Kriminelët shfrytëzojnë problematikën që shoqëron pandeminë COVID-19 për të instaluar viruse (malware) në kompjuterët personal ose telefonat celular. Në disa nga përpjekjet e fundit, kriminelët krijuan e-mail të rremë të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (phishing), instaluan viruse (malware) në aplikacione të telefonave celularë që përdoren për të gjurmuar rastet e të infektuarve si dhe kanë dërguar mesazhe SMS duke pretenduar të jenë personel mjekësor, duke kërkuar pagesa për trajtimin e ofruar ose duke premtuar ofrimin e fondeve për ndihmë emergjente.

Në vijim paraqiten disa nga mënyrat e përdorura për këtë qëllim:

- sulme të postës elektronike (phishing), dhe përdorimi i SMS (smishing);
- mashtrimet nëpërmjet komprometimit të postës elektronike të biznesit (BEC fraud);
- sulmeve kundrejt pagesës (Ransomware).

Ndryshimi i sjelljeve financiare: institucionet financiare kanë mbyllur një pjesë të degëve dhe zhvillojnë aktivitetin e tyre me orare të reduktuara. Në këto kushte klientët të cilët nuk janë të familjarizuar me platformat e shërbimit në internet, mund të jenë më të ekspozuar ndaj mashtrimeve, ndërkohë që klientët që nuk kanë qasje në këto shërbime mund të transferojnë pasuritë në ekonominë informale.

Në vijim paraqiten disa nga rreziqet që ndërlidhen me sjelljen financiare të klientit.

- rritje e numrit të transaksioneve në distancë;
- mungesa e përvojës me platformat në internet;
- shërbime financiare të palicencuara;

Abuzimi me fondet qeveritare ose ndihma financiare ndërkombëtare dhe rreziku i korrupsionit

Kriminelët mund të mashtrojnë në kërkesat që bëjnë për fondet mbështetëse që ofrohen nga qeveria duke u paraqitur si përfaqësues të bizneseve legjitime. Faktorët kryesor të rrezikut ndërlidhen me:

- abuzimin e masave stimuluese të ofruara nga programet qeveritare;

- ndihma financiare ndërkombëtare dhe rreziku në rritje i korrupsionit;

Luhatjet e sektorit financiar: Në kushtet e rënies ekonomike, kriminelët dhe terroristët mund të kërkojnë të investojnë në pasuri të paluajtshme ose biznese me probleme, të cilat mund të përdoren për të gjeneruar para dhe për të fshehur të ardhurat e jashtëligjshme. Mënyra të tjera janë dhe përdorimi i fondeve nga aktivitetet kriminale në procedurat e falimentimit të bizneseve apo ristrukturimi i kredive.

Faktorët kryesor të rrezikut që ndërlidhen me këtë janë:

- rënia ekonomike;
- rritja e transaksioneve me para në të gatshme;
- përdorimi i aseteve virtuale;
- tregtimi mbi bazën e informacionit të brendshëm (insider trading).

Financimi i Terrorizmit: Ekziston shqetësimi se grupet terroriste mund të përdorin krizën e COVID-19 për të mbledhur ose transferuar fonde dhe për të intensifikuar aktivitetin e tyre të jashtëligjshëm. Në mënyrë të përmbledhur, rreziqet e PP/FT që vijnë nga kërcënimet dhe dobësitë e sipërpërmendura konsistojnë në:

- përdorimi në rritje i skemave në internet ose aseteve virtuale, në fazën e shtresimit (layering) për të pastruar të ardhurat e jashtëligjshme;
- Kriminelët gjejnë mënyra për të shfrytëzuar mangësitë në kontrollet e brendshme të kujdesit të duhur, që vijnë si pasojë e punës në distancë;
- rritje të mundshme të transaksioneve jo në përputhje me profilet e klientëve, përdorimin e ekonomisë informale për të siguruar financim, pasi ofruesit tradicionalë mund të jenë mbyllur dhe rritja e qarkullimit të shumave të konsiderueshme të parasë;
- përdorimi i personave juridikë për të mashtruar në fondet qeveritare dhe më pas pastrimi i tyre, duke përfituar nga bizneset e ligjshme, ose për të fshehur fondet përmes procesit të falimentimit;
- kriminelët dhe terroristët që përdorin pandeminë për të vepruar në linja të reja biznesit që karakterizohen nga nivel i lartë likuiditeti dhe përdorim i lartë i parave në të gatshme (kesh);

Disa nga organizata botërore kanë pasqyruar rreziqet për PP/FT si në vijim:

FATF në maj të vitit 2020 ka publikuar një punim të titulluar “Rreziqet e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit dhe përgjigja e politikave ndaj COVID-19”² duke përdorur informacionin dhe dhënë shteteve anëtarë të Rrjetit Global të FATF në Prill 2020. Punimi identifikon rreziqet e mundshme të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit si në vijim:

- Kriminelët që gjejnë mënyra për të anashkaluar masat e KDK duke shfrytëzuar sfidat e përkohshme në kontrollet e brendshme të shkaktuara nga situata e punës nga distanca, në mënyrë që të fshehin dhe pastrojnë fonde;
- Keqpërdorimi i shtuar i shërbimeve financiare online dhe aseteve virtuale për të lëvizur dhe fshehur fonde të paligjshme;
- Shfrytëzimi i masave stimuluese ekonomike dhe skemave të falimentimit si një mjet për personat fizikë dhe juridikë për të fshehur dhe pastruar të ardhurat e paligjshme;
- Ndërsa individët lëvizin para nga sistemi bankar për shkak të paqëndrueshmërisë financiare, kjo mund të çojë në një përdorim në rritje të sektorit financiar të parregulluar, duke krijuar mundësi shtesë për kriminelët për të pastruar fonde të paligjshme;
- Keqpërdorimi dhe përvetësimi i ndihmës financiare vendore dhe ndërkombëtare dhe fondeve emergjente duke shmangur procedurat standarde të prokurimit, duke rezultuar në rritje të korrupsionit dhe pasojave të pastrimit të parave;
- Kriminelët dhe terroristët që shfrytëzojnë COVID-19 dhe rënien ekonomike të ndërlidhur për të lëvizur në linja të reja biznesi me para të gatshme dhe me likuiditet të lartë në vendet në zhvillim, si për pastrimin e të ardhurave ashtu edhe për të financuar operacionet e tyre, si dhe duke pretenduar me mashtrim për bamirëse për të mbledhur fonde në internet.

EUROPOL³ po ashtu në ueb faqe ka publikuar artikuj në lidhje me COVID-19 duke përfshirë një seksion për krimet në rritje që janë raportuar nga policia në të gjithë BE-në.

Këto krime përfshijnë si në vijim:

- Mashtrimet e blerjeve - postimi i reklamave të rreme për produktet, të tilla si ilaçet dhe produktet e higjienës;
- Mashtrime përmes postës elektronike (phishing) dhe mesazheve sms (smishing);

²FATF, 2020 – COVID-19- related Money Laundering and Terrorist Financing Risks and Policy Responses - <https://www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/COVID-19-AML-CFT.pdf>

³EUROPOL, 2020 – COVID-19 – What you need to know– <https://www.europol.europa.eu/activities-services/staying-safe-during-covid-19-what-you-need-to-know>

- Sulme kompjuterike kundrejt pagesës (ransomware);
- Transmetim i paligjshëm;
- Krimi i organizuar i pronës, veçanërisht në shënjestër të grupeve të cënueshme;
- Mashtrim;
- Shfrytëzimi seksual i fëmijëve;
- Dobësitë e të punuarit online nga distanca (teleworking) që çojnë në rrjedhje të të dhënave;
- Virus elektronik (malware) i telefonëve;
- Përhapja e dezinformatave në lidhje me COVID-19 duke rrezikuar shëndetin publik.

INTERPOL⁴ gjithashtu në ueb faqen e saj të internetit i ka kushtuar COVID-19 dhe rreziqeve në zhvillim. Në veçanti, INTERPOL paralajmëron për rreziqet si në vijim:

- Furnizime mjekësore të falsifikuara dhe ilaçe;
- Krimi kibernetik;
- Mashtrimi - online ose telefonike.

UNODC në mesin e mesazheve kryesore vëren si në vijim:

- Mashtrimet fiskale dhe jo-fiskale në lidhje me reagimin e publikut ndaj COVID-19 janë në rritje. Valutat virtuale dhe skemat e tjera piramidale ka të ngjarë të rriten;
- Pastrimi tradicionale i parave me transportues të parave është ulur ndjeshëm përmes porteve dhe aeroporteve. Është e paqartë nëse kriminelët e organizuar do të kërkojnë metoda alternative të dërgesave për financat e tyre kriminale, të tilla si valuta virtuale ose transfer elektronike, ose presin rihapjen e kufijve;
- Grupet transnacionale të krimit të organizuar dhe financuesit e terrorizmit do të kërkojnë të shfrytëzojnë mundësitë për të ofruar shërbime financiare kur zvogëlohen aftësitë e sektorit shtetëror / privat. Rënia ekonomike globale që pason do të paraqesë një mori mundësish për financimet kriminale;

⁴INTERPOL, 2020 – COVID-19 - <https://www.interpol.int/en/Search-Page?search=covid+19>

- Në trafikimin e personave, kriminelët po përshtatin modelet e tyre të biznesit me "normalitetin e ri" të krijuar nga pandemia, veçanërisht përmes abuzimit të teknologjive moderne të komunikimit⁵;
- Ka indikacione se grupet e trafikut të drogës po përshtatin strategjitë e tyre për të vazhduar operacionet e tyre dhe se disa kanë filluar të shfrytëzojnë situatën në mënyrë që të rrisin imazhin e tyre në mesin e popullatës duke ofruar shërbime, në veçanti për vendet e pambrojtura⁶;
- Pavarësisht ndërprerjeve të lokalizuara për shkak të kufizimeve të udhëtimit dhe masave të tjera të distancës shoqërore të miratuara nga qeveritë për të menaxhuar pandeminë COVID-19, ka të ngjarë të ketë pak pauzë në trafikimin e jetës së egër, por në shumë raste, gjuetia pa leje ka të ngjarë të rritet dhe tregtia e paligjshme do të përshtatet me ndryshimin e rrethanave të tregut⁷.

Subjektet raportuese udhëzohen që të përdorin fjalë kyçe (p.sh. COVID) në kërkime dhe raportet e tyre për të përzgjedhë dhe dhënë përparësi RAD-ve hyrëse në lidhje me COVID-19, si dhe që të njoftojnë pa vonesë NjIF-K për çdo vonesë ose pengesë të hasur në raportim gjatë kësaj periudhe.

Dardan **NUHIU**
Drejtori i Njesisë për Inteligjencë Financiare

⁵UNODC, 2020 – Impact of the COVID-19 pandemic on trafficking in persons - https://www.unodc.org/documents/Advocacy-Section/HTMSS_Thematic_Brief_on_COVID-19.pdf

⁶UNODC, 2020 – COVID-19 and the drug supply chain: from production and trafficking to use - <https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/covid/Covid-19-and-drug-supply-chain-Mai2020.pdf>

⁷UNODC, 2020 – Preventing future pandemics of zoonotic origin by combating wildlife crime: protecting global health, security and economy - https://www.unodc.org/documents/Advocacy-Section/Wildlife_trafficking_COVID_19_GPWLFC_public.pdf

Treguesit / Indikatorët⁸

1. Indikatorët e shënuar më poshtë synojnë ngritjen dhe vetëdijesimin e subjekteve raportuese në pajtim rreziqet në rritje dhe trendët gjatë periudhës COVID-19 . Këta indikatorë në vijim nuk nënkuptohet se janë të vetmit por vetëm ofrojnë shembuj bazikë.

Mashtrime përmes postës elektronike (phishing) dhe mesazheve sms (smishing)

- Adresat e postës elektronike që supozohet se lidhen me COVID-19 nuk përputhen me emrin e dërguesit ose me domenin përkatës të kompanisë që pretendohet se dërgon mesazhin;
- E-mail në lidhje me COVID-19 nga burime të pasigurta që inkurajojnë lexuesit të hapin linkun/façen e ndërlidhur ose kërkojnë të ofrojnë informacione personale ose financiare, të tilla si emrat e përdoruesve dhe fjalëkalimet ose kredencialet e tjera të llogarisë;
- E-mail nga burime të pasigurta ose adresa të ngjashme me llogaritë e shitësve të ligjshëm përmes televizionit që ofrojnë softuer aplikimi nga distanca, shpesh të reklamuar pa ndonjë kosto apo me kosto të vogël;
- Email-et që përmbajnë në subjekt tituj të identifikuar sikurse nga qeveria ose institucionet publike apo mbështetëse (p.sh. "Përditësimet e Koronavirusit", '2020-IKSHP-COVID.org,"Raste të reja të konfirmuara në Qytetin tuaj"'2020-Prishtina.online: "Shpërthimi i Koronavirusit në Qytetin tuaj" Pandemia – komuna.com';
- Mesazhet me tekst që ndërlidhen ose pretendojnë të jenë ose shoqërohen me programe dhe pagesa të ndihmave qeveritare;
- Linqet e ndërlidhura ose adresat e ueb faqeve të internetit për burimet e pretenduara COVID-19 kanë lokalizues parregullt të burimeve (URL) që nuk përputhen me atë të faqes së pritur ose janë të ngjashme me faqet e ligjshme, por me ndryshime të vogla në domen (p.sh. variacione në zgjerimet e domenit si '.com', dhe '.Org' ose shqiptim i adresës.

Skemat e mashtrimit për postës elektronike të biznesit (BEC fraud)

- Përshkrimet e transaksionit të klienti përmbajnë gjuhë, kohë dhe shuma të ndryshme në krahasim me përshkrimet e mëparshme të transaksionit, veçanërisht në lidhje me transaksionet që përfshijnë ofruesit e kujdesit shëndetësor ose blerjet e furnizimeve;

⁸ECOFEL, 2020 - Covid-19 Best Practices for Financial Intelligence Units

- Përshkrimet e transaksionit, zakonisht përfshijnë palë të sektorit të kujdesit shëndetësor ose i referohen blerjeve që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor ose furnizimit të reagimit emergjent nga llogari e-maili që ngjan shumë, por jo identike me llogarinë e e-mailit të klienti të njohur;
- Përshkrimet e transaksioneve të dërguara drejtojnë pagesat në llogari tjetër dhe përfitues të njohur. Dërguesi mund të pretendojë nevojë për të ndryshuar llogarinë e dërgimit si shkak i një përgjigje ndaj pandemisë COVID-19, të tilla si zhvendosja e llogarisë në një institucion financiar në një juridiksion më pak të prekur nga sëmundja dhe të pretendojë urgjencën për të kryer transaksionin;
- Përshkrimet e transaksionit të dërguara kërkojnë të zhvendosin metodat e pagesës nga çeket në transfere elektronike bankë në bankë si një përgjigje ndaj pandemisë.

Mashttrimet në lidhje me shitjet gjatë COVID-19 (përfshirë pajisjet mjekësore)

- Shitësit që shesin COVID-19 test kite, kura dhe trajtime apo shërbime të dekontaminimit shtëpiak;
- Transaksionet që përfshijnë shitjen ose prokurimin e pajisjeve mbrojtëse personale ose materialeve të tjera mjekësore ose higjienike që janë shumë të kërkuara për shkak të pandemisë, me çmime mjaft të ulëta;
- Fillimi i papritur dhe vëllimi i lartë i transfereve elektronike në llogaritë bankare të klientëve që pretendojnë të përfshihen në tregti elektronike (e-commerce). Fondet pakësohen menjëherë ose transferohen në llogari tjetër pas marrjes;
- Përdorimi i llogarive bankare personale për qëllime biznesi, veçanërisht ato të ndërlidhura me platformat e tregtisë elektronike;
- Autoritetet e ndryshme që kanë identifikuar kompani, shitës ose pronar të bizneseve si shitës të produkteve mashtruese;
- Klienti i bankës ose institucionit financiar ka faqe në internet me një ose më shumë tregues të dyshimit, duke përfshirë një emër/adresë të internetit të përafërt me kompanitë reale dhe të njohura dhe/ose ka aftësinë për të blerë barna pa recetë kur zakonisht kjo kërkohet;
- Imazhet e markave të produkteve të tregtuara në internet duket se janë paksa të ndryshme nga imazhet e produktit të ligjshëm, të cilat mund të sugjerojnë për një produkt të falsifikuar;

- Shitësi kërkon pagesa që janë të pazakonta për llojin e transaksionit ose të pazakonta për modelin e sjelljes së industrisë. Për shembull, në vend të një pagese me kartë krediti, shitësi kërkon karta të parapaguara, përdorimin e shërbimeve të dërgimit të parave, valutë virtuale të konvertueshme ose që blerësi të dërgojë fonde përmes një transferi elektronik të fondeve në një juridiksion me rrezik të lartë;
- Bankat dhe institucionet financiare mund të zbulojnë modele të kthimeve të ngarkesave administrative (charges) dhe normave të larta të kthimit në llogaritë e klientëve të tyre. Këto modele mund të jenë tregues të mashtrimit të përgjithshëm të shitësve;
- Shitësi nuk duket se ka një histori të gjatë të biznesi (p.sh. biznesi është krijuar brenda muajve të fundit), i mungon prania fizike ose adresa, ose i mungon numri unik i identifikimi NUI (ose i ngjashëm). Për më tepër, nëse shitësi ka adresë, mirëpo ka mospërputhje të dukshme midis adresës dhe regjistrave publik për kompaninë ose adresës së rrugës, apo shumë biznese ndodhen në të njëjtën adresë, ose shitësi ndodhet në një juridiksion me rrezik të lartë ose rajon që zakonisht nuk ndërlidhet me mallrat që ata shesin;
- Shitësit hezitojnë të sigurojnë klientin ose bankës apo institucionit financiar që përpunon transaksionet faturat ose dokumente të tjera që mbështesin qëllimin e deklaruar të pagesave në lidhje me shitblerjen;
- Banka dhe apo institucioni financiar nuk e kupton modelin e biznesit të shitësit dhe ka vështirësi në përcaktimin e natyrës së vërtetë të kompanisë dhe operacioneve të saj;
- Shitësi nuk mund të sigurojë numrin identifikues të dërgesave te klienti ose dëshmi të dërgesës në bankë apo institucion financiar në mënyrë që të mund të procedoj me transaksione financiare në fjalë;
- Shitësi pretendon se në momente të fundit ka vonesa të dyshimta në dërgesën ose pranimin e mallrave. Për shembull, shitësi pretendon se pajisjet janë ndalur në port ose nga autoritetet, se doganat nuk e kanë lëshuar dërgesën, ose se dërgesa është vonuar në anije dhe nuk mund të sigurojë asnjë informacion shtesë në lidhje me anijen te klienti, banka ose institucioni i tyre financiar;
- Shitësi nuk mund të shpjegojë burimin e mallrave ose sesi shitësi fitoi furnizime me shumicë të mallrave shumë të kërkuar në lidhje me pandeminë COVID-19;
- Një llogari e sapo hapur pranon transfere të shumta elektronik edhe mbajtësi i llogarisë kishte dështuar ta përmendte gjatë procesit të hapjes së llogarisë;
- Klienti bën depozita jashtëzakonisht të mëdha që nuk janë në përputhje me profilin e klientit ose historikun e llogarisë. Pas një kërkimi të mëtejshëm rreth klientit, dhe/ose

hulumtimi në burime të hapur tregon se klienti po shiste mallra të lidhura me COVID-19 që zakonisht nuk shiten nga ky klient;

- Shitja e materialeve COVID-19 gjeneron flukse hyrëse të parave në të gatshme, por asnjë shpenzim në lidhje me këtë aktivitet nuk regjistrohet në llogari. Ky është veçanërisht rast nëse të gjitha faturat e parave të gatshme përdoren për qëllime private nga mbajtësi i llogarisë.

Mashtrimet në lidhje me identitetin dhe përfitimet e urgjencës gjatë COVID-19

- Rritja e menjëhershme e transaksioneve të mëdha që përfshijnë llogari të klientëve, ku kishte një bilanc të ulët dhe/ose aktivitet të mëparshëm të kufizuar financiar, ose pagesa të drejtpërdrejta të një përfituesi me të cilin klienti nuk ka histori pagese ose marrëdhënie biznesi, mund të tregojë viktimizim të mashtrimit ose pastrim të të ardhurave nga aktivitetet e mashtrimit;
- Llogaritë të hapura së fundmi me qëllim të pranimit të ndihmesës nga programet qeveritare, të cilave u mungojnë transaksionet e zakonshme që lidhen me shpenzimet e përditshme të jetesës;
- Llogaritë bankare të hapura gjatë pandemisë në një vend që nuk është vendbanimi i klientit;
- Klienti i tërheq në tërësi pagesa e ndihmesës nga qeveria përkatëse të depozituar në llogari ose i përcjell përfitimet në një llogari tjetër menjëherë pas marrjes së përfitimeve ose pas një periudhe pasiviteti.

Transaksionet e ndërlidhura të jashtëzakonshme gjatë COVID-19

- Aktiviteti dhe transaksionet janë atipike ose nuk janë përputhje me profilin financiar të klientit ose nuk mund t'i përmbushë kërkesat e subjektit raportues për informacione të mëtejshme në lidhje me aktivitetin financiar të klientit, me COVID-19 të dhënisi shpjegim;
- Shkëmbime të mëdha valutash për një qëllim të paqartë ose për qëllime të udhëtimit që nuk është i besueshëm duke pasur parasysh pandeminë;
- Depozita të mëdha të parave në të gatshme ku burimi i fondeve është i paqartë, ose jo i besueshëm duke pasur parasysh pandeminë;
- Transaksione që përfshijnë llogari biznesi të cilat paraqiten në kundërshtim me situatën pandemike;

- Shpjegimet për transaksionet që konsiderohen të pamundura duke pasur parasysh profilin e biznesit dhe ndikimin e parashikuar të pandemisë në modelin e funksionimit (p.sh. restorante, bare, palestra, industria e udhëtimeve etj.);
- Depozita të mëdha të pazakonta të parave në të gatshme në llogaritë e biznesit, veçanërisht në sektorët më të ndikuar nga pandemia COVID-19 ose jashtë normës për çdo lloj biznesi;
- Transaksione të pazakonta ose të dyshimta që përfshijnë shitjen ose prokurimin e pajisjeve personale mbrojtëse ose materialeve të tjera mjekësore ose higjienike që janë shumë të kërkuara për shkak të pandemisë COVID-19. Transaksionet mund të përfshijnë individë që kërkojnë të blejnë sasi të vogla ose prokurime në shkallë të gjerë nga institucionet;
- Transaksionet që mund të ndërlidhen me variacionet COVID-19 të skemave ekzistuese në treg të mashtrimit masiv;
- Tërheqjet e mëdha të parave në të gatshme nga individët mund të jenë tregues i viktimizimit të mashtrimit ose pastrimit të produkteve të veprimtarisë së mashtrimit, shpesh duke përdorur mushka (mules) që mund të jenë viktimizuar më parë;
- Udhëzimet për transfer merren nga një llogari e-maili që i ngjan shumë llogarisë së postës elektronike të klientit. Sidoqoftë, adresa e postës elektronike është modifikuar pak nga shtimi, ndryshimi ose fshirja e një ose më shumë karaktereve. Për shembull, contact@emri dhe mbiemri.com në vend të contact@emri dhe mbiemri.ks.

Mashtrimet në lidhje me proceset e identifikimit në distancë gjatë COVID-19

- Fotografitë në dokumentacionin e identitetit, veçanërisht zonat përreth fytyrave, janë të paqarta ose me rezolucion të ulët, ose kanë devijime. Fotografitë në dokumentacionin e identitetit ose imazhe të tjera të personave në verifikim të identitetit në distancë tregojnë shenja vizuale që tregojnë manipulimin e mundshëm të figurës (p.sh. mospërputhjet në ngjyrosjen afër skajeve të fytyrës, ose skajet ose vijat e dyfishta në tiparet e përcaktuara të fytyrës);
- Imazhet e dokumentacionit të identitetit kanë parregullsi vizuale që tregojnë manipulimin digjital të imazheve, veçanërisht rreth fushave të informacionit që mund të ketë ndryshuar për të kryer mashtrim sintetik të identitetit (p.sh. emri, adresa dhe identifikuesit e tjerë);
- Përshkrimi fizik i klienti në dokumentacionin e identitetit nuk përputhet me imazhet e tjera të klientit;

- Një klient refuzon të sigurojë dokumentacion shtesë të identitetit ose vonesa në ofrimin e dokumentacionit shtesë;
- Identifikimet e klientëve ndodhin nga një pajisje e vetme ose adresa e protokollit të Internetit (IP) përmes llogarive të shumta që duken sikur nuk ndërlidhen, shpesh brenda një periudhe të shkurtër kohe;
- (IP)adresa që ndërlidhet me qasjen (log in) nuk përputhet me adresën e deklaruar në dokumentacionin e prezantuar;
- Qasjet e klientëve ndodhin brenda një modeli kur ka trafik të lartë të rrjetit me nivele të ulura të suksesit të qasjes dhe rritje të rivendosjes së fjalëkalimit;
- klienti telefonon bankën apo institucion financiar për të ndryshuar metodat e komunikimit dhe informacionin e vërtetimit për llogarinë, pastaj shpejt përpiqet të kryejë transaksione në një llogari që nuk ka marrë më parë pagesa nga klienti;

Tipologjitë gjatë periudhës COVID-19

Rasti (I)




Figura 1: Burimi NjIF-K (paraqitja skematike e rastit I)

Personi A si pronar i subjektit “ABC” në Shtetin “X” ka kontaktuar personin K nga Shteti “Y” dhe e ka autorizuar që të hap firmën “CDF” në Shtetin “Y” për të realizuar transaksione ndërkombëtare si Ndërmjetësues. Subjekti në fjalë “CDF” ka hapur llogarinë bankare me numër XXXXXXXXXXXX në mënyrë që të pranoj një transfer ndërkombëtar në shumën totale prej 78,000,000.00€ nga subjekti “GHT” në Shtetin “Z” me qëllim të “Shitblerjes së Maskave”. Pas pranimit të këtyre mjeteve Subjekti “CDF” është autorizuar nga Personi A që mjetet në vlerë prej 75,000,000.00€ ti transferoj tek subjekti “UJV” në Shtetin “W” me përshkrimin “Pagesë për blerje të maskave”. Dyshimi ka qenë se subjekti “GHT” dhe subjekti “UJV” nuk merren me shitblerje të maskave por janë të fushave të ndryshme të prodhimit dhe shitblerjes ku subjektet “GHT” merret me *Shitblerjen e Pemëve dhe Perimeve* ndërsa subjekti “UJV” merret me *Prodhimin e Lllamarinës*. Gjithashtu në faturën e prezantuar për realizimin e transferit me përshkrimin “Për shitblerjen e Maskave” ceket se shuma e shitblerjes është 75,000,000.00€ ndërsa që do të transferohet nga Shteti “Z” për në Shtetin “Y” është 78,000,000.00€. Nga dyshimet e ngritura nuk është lejuar realizimi i këtij transferi nga subjekti raportues.

Rasti (II)




Figura 2: Burimi NjIF-K (paraqitja skematike e rastit II)

Subjekti “F” ka pranuar mjete nga Subjekti “M” në emër të pagesës për pajisje medicinale anti-COVID. Pronar i këtij subjekti është **Personi “A”**. Pas pranimit të këtij transaksioni subjekti në fjalë transferon disa nga mjetet e pranuar tek Subjekti “S” me pronar personin “B”. Transferet kanë përshkrimet si “*pagesë fature*”, “*pagesa për mallra*” etj.

Dyshohet se arsyeja e vërtet e transferimit të këtyre mjeteve është që Personi “B” ka precedent penal dhe duke qenë i ngarkuar dhe dënuar për një numër të konsiderueshëm veprash penale nuk mundet personalisht dhe përmes subjektit të tij afarist të aplikoj për tender dhe këtë e bënë përmes biznesit tjetër “F” pas të cilit dyshohet që qëndron po ai.

Rasti (III)




Figura 3: Burimi NjIF-K (paraqitja skematike e rastit III)

Personi A është pronar e Subjektit X, ku ky subjekt ka të hapur llogari bankare në Kosovë llogaria: 0000000000001 EUR dhe në këtë llogari personi A ka deponuar në para të gatshme (cash) shumën prej 300,000.00 € dhe përshkrimi për këtë deponim ka qenë “Huazim nga pronari, mjete nga kursimet familjare”. Personi A ka kryer një transfer në vlerë 250,000.00 € nga llogaria e subjektit X në llogarinë e subjektit Y llogaria: 000000000000006 me përshkrimin “Huazim nga pronari për një periudhë prej 45 ditë”, personi A është po ashtu pronar i subjektit Y.

Personi A në fillim të pandemisë ka transferuar nga llogaria e Subjektit Z, llogaria:0000000000008, në llogarinë e Subjektit X shumën prej 80,000.00€ me përshkrimin “Huazim”. Nga llogaria e Subjektit X, për një periudhë të shkurtë kohore janë transferuar shuma prej 600,000.00€ në llogarinë e subjektit T llogaria: 11111111155555EUR, të hapur në shtetin J, përshkrimet e transfereve kanë qenë “ Pagesë për Teste për COVID-19”.

Dyshimet janë se personi A, si dhe subjektit X janë të përfshira në aktivitete të dyshimta. Pas verifikimit të këtyre transfereve, NJIF-K ka vërejtur që Subjektit X, pasi ka kryer pagesat në bazë të faturave, produktet farmaceutike nuk figurojnë të importuara që kanë hyrë në Kosovë dhe se dyshohet që këtu mund të ketë pastrim parash në mënyrë klasike nga personi A, Subjektit X dhe Subjektit T. Deponimet dhe transferet mes llogarive dhe përshkrimet jo të qarta ekonomike të këtyre deponimeve dhe transfereve ngritin po ashtu dyshimin për pastrim parash.